



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi -Skupština -Assembly**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVA**

Raport vjetor

2012

**Prishtinë
Mars 2013**

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	2
II.	PJESA E PËRGJITHSHME	3
III.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KËSHILLIT	4
IV.	FUNKSIONET E KËSHILLIT	5
A.	FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE	5
1.	Ankesat e arritura sipas objektit:	6
2.	Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve:	6
3.	Ankesat e ushtruara, sipas strukturës etnike:	7
4.	Ankesat e ushtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit	8
B.	ANKESAT E PARAQITURA NË KËSHILL GJATË VITIT 2012	8
1.	Administrata qendrore	8
2.	Agjencitë, Institucionet dhe Organet e pavarura	10
3.	Administrata lokale (komunat)	13
C.	ANKESAT E SHQYRTUARA GJATË VITIT 2012	14
1.	Administrata qendrore (ministrinë)	15
2.	Administrata lokale - (Komunat)	16
3.	Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura	18
	Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura.....	18
D.	ANKESAT E ZGJIDHURA GJATË VITIT 2012 DHE MËNYRA E ZGJIDHJES SE TYRE	22
1.	Të aprovuara	22
2.	Pjesërisht të aprovuara	22
3.	Të refuzuara	22
4.	Të hedhura poshtë	22
5.	Të shpallura jo-kompetent	22
6.	Kthimi në ri- shqyrtim (Ex-officio)	23
7.	Përfundim procedimi	23
8.	Të pezulluara	23
9.	Tërheqje e ankesës	23
10.	Saktësimi i vendimit	23
E.	ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT	24
F.	FUNKSIONI I MBIKËQYRJES	26
1.	FUSHAT E MBIKËQYRJES NË SHËRBIMIN CIVIL	26
V.	BUXHETI	37
A.	MBIKËQYRJA E SHPENZIMEVE	37
VI.	BASHKËPUNIMI	38
VII.	PROBLEMET DHE VËSHTIRËSITË	38
VIII.	PËRFUNDIM	39

I. HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës, i paraparë me nenin 101 pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe aktet nëligjore të tij, Rregullorja nr.01/2011 mbi Organizimin e Brendshëm, Rregullorja nr. 02/2011 për Procedurën e Zgjidhjes së Ankesave dhe Kodi i Etikës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për shërbimin civil, Ligji nr. 02/L-028 për Procedurën Administrative si dhe ligjet të cilat ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli gjatë gjithë vitit 2012, ka qenë i angazhuar që të sigurohet një shërbim civil cilësor në frymën profesionale, duke zbatuar legjislacionin për shërbimin civil që Kosova të ketë një administratë efikase me vlera dhe standarde evropiane.

Këshilli është organizatë buxhetore e pavarur, financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet e ndryshme.

II. PJESA E PËRGJITHSHME

Më qëllim që Republika e Kosovës të ketë një shërbim civil efikas, të paanshëm, i bazuar në parimin e meritës dhe që pasqyron diversitetin e popullit të Kosovës, Këshilli, gjatë kryerjes së funksioneve të tij për periudhën raportuese, përmes shqyrtimit të ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për punësim në shërbim civil, mbikëqyrjen e respektimit të ligjit dhe parimeve udhëheqëse në shërbimin civil si dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve të nivelit drejtues, ka konstatuar se në shërbimin civil ka një progres, por ende nuk është arritur profesionalizmi i duhur, paanshmëria, përgjegjshmëria, respektimi i kodit etik si dhe zbatimi i procedurave dhe ligjit.

Nga shqyrtimi i ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për punësim konstatohet se nëpunësit civilë nuk rekrutohen, avancohen gjithëherë, sipas procedurave të shërbimit civil dhe parimit të meritës, vlerësimet e rezultateve në punë nuk bëhen gjithëherë në mënyrë objektive, kontratat e punës për nëpunës civilë nuk janë zëvendësuar në të gjitha institucionet në shkresë emërimi (Akt Emërimi) pa afat të caktuar brenda një viti, siç e ka përcaktuar Ligji për shërbimin civil dhe rekomandimet që i ka dhënë Këshilli.

Disa nga nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues (Zyrtarët Kryesor Administrativ), përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e vendimeve të Këshillit, gjë që në pajtim me nenin 15 paragrafi 1 dhe paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin, Këshilli rregullisht ka njoftuar më shkrim Kryeministrin, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe eprorët e secilit institucion që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit, edhe pse njoftimet kanë qenë raporte disiplinore sipas ligjit nuk është ndërmarrë as edhe një rast i vetëm disiplinor.

Nga mbikëqyrja e institucioneve për respektim të ligjit, është konstatuar se ende jo të gjitha institucionet kanë dosjet e personelit në nivelin e standardeve, përshkrimet e punës të standardizuara, komisionet disiplinore dhe të ankesave, që zbatojnë parimet që shpesh bëhen instrumente me ndikim dhe nën presion në vendimmarrje, paanshmëria dhe pavarësia profesionale dhe mundësitë e barabarta për komunitete dhe gjini nuk janë nivelin e kënaqshëm sipas bazës ligjore, zyrave të personelit dhe menaxherëve të personelit nuk iu është dhënë roli dhe përgjegjësia që duhet t'ia kenë sipas ligjit. Disa nga institucionet të cilave u janë dërguar rekomandime kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e tyre, por edhe nuk e kanë njoftuar Këshillin për zbatimin ose mos zbatimin e tyre.

Nga vëzhgimet për zgjedhjen e nëpunësve të nivelit drejtues është bërë një përmirësim i dukshëm me kontributin e veçantë të Këshillit, duke mos lejuar zgjedhjen përfundimtare pa u plotësuar kushtet ligjore të shërbimit civil qoftë rreth konkursit, nivelit dhe përbërjes së komisioneve intervistuese, duke konstatuar se anëtarët e komisioneve janë nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues dhe pozitive ekuivalente, por është vërejtur se disa institucione nuk kanë treguar gatishmëri për bashkëpunim.

III. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KËSHILLIT

Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe më Rregulloren e Brendshme mbi Organizimin e tij dhe Kodin e Etikës, ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe standardet e sjelljes së anëtarëve të Këshillit.

KËSHILLI përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen përmes konkursit të hapur dhe transparent të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor të Kosovës. Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar me mundësi rizgjedhje. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit me mandat dy vjeçar.

SEKRETARIATI i Këshillit, është organ që ndihmon Këshillin në realizimin e funksioneve dhe detyrave, sipas Rregullres mbi Organizimin e Brendshëm dhe

përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe dy departamente. Aktualisht në Sekretariatit e Këshillit janë të angazhuar 16 të punësuar në cilësinë e nëpunësve civilë.

- Drejtori Ekzekutiv;
- Departamenti i Ankesave, Monitorimit dhe Vëzhgimit (8 nëpunës);
- Departamenti i Administratës dhe Personelit (7 nëpunës);

Kapitujt në vijim paraqesin një pasqyrim të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga ana e Këshillit si dhe aktivitetet e kryera nga Këshilli gjatë periudhës një (1) vjeçare të raportimit, **1 Janar - 31 Dhjetor 2012**.

IV. FUNKSIONET E KËSHILLIT

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin, Këshilli ka tri funksione:

1. Funksioni i shqyrtimit të ankesave, shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për punësim në shërbimin civil kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës
2. Funksioni i vëzhgimit, vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës.
3. Funksioni i Mbikëqyrjes, mbikëqyr zbatimin e të gjitha rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

A. FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Gjatë vitit **2012** në Këshill kanë arritur gjithsejtë **375** ankesa, të parashtruara nga nëpunësit civilë dhe kandidatët për punësim në Shërbim Civil të Kosovës. Në mënyrë që të specifikohen më saktësisht natyra e ankesave, Këshilli në këtë raport ka ndarë ankesat sipas:


- a) **objektit** të ankesave,
- b) strukturës **gjinore** dhe
- c) strukturës **etnike**.

1. Ankesat e arritura sipas objektit:

Baza e ankimit të nëpunësve civilë që ankohen në Këshill, është e ndryshme. Gjatë vitit 2012 shumica e ankesave, kanë pasur për objekt, kompensim i pagave dhe shtesave, kontestimin e konkurseve, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, masa disiplinore, transferim, vlerësimin e kryerjes së punëve, avancimin dhe statusin e karrierës. (Shif Tabelën e mëposhtme)

Objekti i ankesave	Numri	Përqindja
1. Kompensimi i pagave dhe shtesave	139	37.07%
2. Kontestim konkursi	80	21.33%
3. Ndërprerje e marrëdhënies së punës	73	19.46%
4. Masa disiplinore	45	12.00%
5. Transferim	25	6.66%
6. Vlerësimi i rezultateve në punë	8	2.13%
7. Avancim	3	0.80%
8. Plotësim i normës së orëve	1	0.26%
9. Status karriere	1	0.26%
Gjithësejt	375	

Fig 1. Tregon përqindjen e ankesave të arritura, sipas objektit.



2. Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve:

Nga numri i përgjithshëm i ankesave prej 375 të arritura në vitin 2012, në bazë të gjinisë dhe grupeve të ankuesve të cilët i janë drejtuar Këshillit, del se numri më madh i ankuesve janë meshkuj - 303 ose 80.80 %, ndërkah femra 70 ose 18.67 %. Nga numri i përgjithshëm prej 375 ankesave, të tjera 2 ose 0.53 % (ankesa nga Institucione) nëse ndahet në përqindje në formë grafiku duket kështu:




Fig 3. Tregon përqindjen e ankuesve sipas strukturës gjinore

3. Ankesat e ushtruara, sipas strukturës etnike:

Struktura etnike e ankuesve që i janë drejtuar Këshillit është: shqiptarë - 359 ose 95.73%; serb - 12 ose 3.20 %; turq 2 ose 0.53%. boshnjak - 2 ose 0.53 %.




Fig 4. Tregon përqindjen e ankuesve sipas përkatësisë etnike

4. Ankesat e ushtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga nëpunësit civil dhe kandidatët për punësim nga Institucionet e Administratës Qendrore (ministritë) janë **118** ankesa ose **31.47%**, nga Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura **97** ose **25.80%** dhe nga Administrata lokale (komunat) **160** ankesa ose **42.67%**.




Fig. 5 Tregon përqindjen e ankesave ndaj vendimeve të autoriteteve punëdhënëse

B. ANKESAT E PARAQITURA NË KËSHILL GJATË VITIT 2012

Ankesat, e paraqitura në Këshill, sipas institucioneve dhe objektit janë:

- 1) Administrata qendrore;
- 2) Agjencitë, Institucionet dhe Organet e pavarura dhe
- 3) Administrata lokale (komunat).

1. Administrata qendrore

Nëpunës civil dhe kandidatët për punësim në shërbimin civil nga Administrata Qendrore (ministritë) gjatë vitit 2012 kanë ushtruar **118** ankesa. (Shih Tabelën e më poshtme).

Nr.	Institucionet e Administratës Qendrore	Nr. i ankesave	Përqindja
1	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	23	6.13%
2	Ministria e Infrastrukturës	12	3.20%
3	Ministria e Drejtësisë	11	2.93%
4	Administrata e Kuvendit të Kosovës	10	2.67%
5	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	9	2.40%
6	Ministria e Punëve të Jashtme	9	2.40%
7	Ministria e Punëve të Brendshme	8	2.13%
8	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	7	1.87%
9	Ministria e Shëndetësisë	6	1.60 %
10	Ministria e Financave	5	1.33%
11	Ministria e Komuniteteve dhe Kthim	3	0.80%
12	Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal	3	0.80%
13	Ministria e Administratës Publike	2	0.53%
14	Administrata e Zyrës së Kryeministrit	2	0.53%
15	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2	0.53%
16	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	2	0.53%
17	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	0.27%
18	Administrata e Presidencës	1	0.27%
19	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1	0.27%
20	Ministria e Diasporës	1	0.27%
	Gjithsejtë	118	31.47%

Fig. 6 Tregon përqindjen e ankesave ndaj vendimeve të autoriteteve punëdhënëse

Ankesat e arritura kundër Institucioneve të Administratës Qendrore	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	Mosvazhdim i punësimit	Konkestim konkursi	Kompenim.material	Ujje në pozitë	Pezullim	Masa disiplinore	Ndërrimi i vendit të punës	Ngritje e koeficientit	Transferim	Kthimi në vendin e punës	Vlerësimi i punës	Avancim	Gjithsejtë
Min. e Tregtisë dhe Industrisë	7	-	3	4	1	1	-	-	-	2	-	5	-	23
Min. e Infrastrukturës	3	1	2	-	3	1	-	-	-	1	1	-	-	12
M. e Drejtësisë	-	-	3	3	1	-	-	-	4	-	-	-	-	11
Administrata e Kuvendit	-	-	1	9	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10
Min. e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1	-	4	-	1	-	-	-	1	-	1	-	1	9
Min. e Punëve të Jashtme	1	-	4	-	2	1	-	1	-	-	-	-	-	9
Min. e Punëve të Brendshme	2	-	4	-	-	-	-	-	2	-	-	-	-	8
Min. e Kulturës, Rinisë e Sportit	4	1	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	7
Min. e Shëndetësisë	2	-	1	2	-	-	1	-	-	-	-	-	-	6
Min. e Financave	-	-	-	2	1	-	-	-	1	-	1	-	-	5
Min. e Admin. të Pushtetit Lokal	-	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Min. për Komunitete dhe Kthim	2	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Min. e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	2
Min. e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	-	-	-	-	-	-	1	-	1	-	-	-	-	2
Min. e Administratës Publike	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Zyra e Kryeministrit	-	-	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Min. e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Min. e Zhvillimit Ekonomik	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Min. Diasporës	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Zyra e Presidentit	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Gjithsejtë	23	2	31	24	9	4	2	1	9	3	3	5	2	118

Fig. 7 Tregon numrin e ankesave të ushtruara, sipas objektit të ankesës ndaj Institucioneve të Administratës qendrore

2. Agjencitë, Institucionet dhe Organet e pavarura

Nëpunës civil dhe kandidatët për punësim në shërbimin civil nga Agjencitë e pavarura, gjatë vitit 2012 kanë ushtruar **97** ankesa me objekt ankese. (shih tabelat e mw poshtme).

Nr.	Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura	Nr. i ankesave	Përqindja
1	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	19	5.07%
2	Agjencioni Pyjor i Kosovës	7	1.87%
3	Administrata Tatimore e Kosovës	5	1.33%
4	Agjencioni Kundërkorrupsionit	5	1.33%
5	Policia e Kosovës-Administrata	5	1.33%
6	Agjencia e Kosovës për Privatizim	5	1.33%
7	Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)	5	1.33%
8	Institucioni i Avokatit Popullit	4	1.07%
9	Universiteti i Prishtinës	4	1.07%
10	Komisioni Qendror Zgjedhor	3	0.80%
11	Këshilli Prokurorial i Shtetit	3	0.80%
12	Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale	3	0.80%
13	Agjencioni i Statistikave të Kosovës	3	0.80%
14	Qendra e Studentëve	2	0.53%
15	Agjencioni Kadastral	2	0.53%
16	Agjencioni Ushqimit dhe Veterinarisë	2	0.53%
17	Doganat e Kosovës	2	0.53%
18	Njësia e Inteligjencës Financiare	2	0.53%
19	Spitali Rajonal -Ferizaj	2	0.53%
20	Spitali Rajonal- Pejë	2	0.53%
21	Universiteti i Prizrenit	1	0.27%
22	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	1	0.27%
23	Agjencioni i Kosovës për Siguri Publike -Vushtrri	1	0.27%
24	QKMF-Klinë	1	0.27%
25	Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit	1	0.27%
26	QKMF-Prizren	1	0.27%
27	Inspektorati Policor i Kosovës	1	0.27%
28	Komisioni për Ndihmë Juridike	1	0.27%
29	Instituti i Historisë	1	0.27%
30	Komisioni Pavarur për Media	1	0.27%
31	Agjencioni Shtetor Arkivave	1	0.27%
32	Agjencioni i Aviacionit Civil të Kosovës	1	0.27%
	Gjithsejtë	97	25.85%

Fig. 8 Pasqyron te dhënat mbi numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill gjatë vitit 2012 nga Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura.

Ankesat e arritura kundër Agjencie, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura sipas objektit	Ndërprerje e marrdh. së punës	Mos vazhdim i punësimit	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ulje në pozitë	Vlerësim i i punës	Masa disiplinore	Ndërrimi i vendit të punës	Kontestim i aktëmerimit	Transferim	Pezullim	Ngarkim i pozitës shtrësë	Rritje e koef.	Gjithsejtë
Këshilli Gjyqësor i Kosovës			4	14	-	-	-	-	1	-	-	-	-	19
Agjencioni Pyjor i Kosovës	3	1	-	-	-	-	1	-	-	-	2	-	-	7
Agjencioni Kundërkorrupsionit	-	-	4	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	5
Policia e Kosovës -Adminsitrate	1	-	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5
Administrata Tatimore të Kosovës	4	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	5
Agjencia Kosovare e Privatizimit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	4	5
Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK	-	-	2	1	2	-	-	-	-	-	-	-	-	5
Universiteti i Prishtinës -Adminsitrate	-	-	-	2	1	-	-	-	-	1	-	-	-	4
Institucioni i Avokatit të Popullit	-	-	2	-	-	1	1	-	-	-	-	-	-	4
Komisioni Qendror Zgjedhor	-	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Prokuroria e Shtetit -Adminsitrate	-	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Agjencioni për Produkte Medicinale	1	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Agjencioni i Statistikave të Kosovës	2	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Agjencioni Kadastral i Kosovës			1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Qendra e Studentëve	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Dogana e Kosovës- -Adminsitrate	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	1	-	2
Njësia e Inteligjencës Financiare	-	-	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Spitali Rajonal -Ferizaj	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	2
Universiteti i Prizrenit	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
QKMF-Klinë	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
QKMF- Prizren	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Inspektorati Policor -Adminsitrate	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Komisioni për Ndhimë Juridike	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1
Instituti i Historisë	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Komisioni Pavarur për Media	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Agjencioni i Aviacionit Civil të Kosovës	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Gjithsej	17	6	31	20	4	2	4	1	1	1	5	1	4	97

Fig.9 Pasqyron numrin e ankesave të ushtruara, sipas objektit të ankesës kundër Agjencie, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura

3. Administrata lokale (komunat)

Nëpunësit civil dhe kandidatët për punësim në shërbimin civil nga administrata lokale gjatë vitit 2012 kanë ushtruar **160** ankesa, me objekt ankese. (Shih tabelat e mwposhtwme)

Nr.	Administrata lokale (komunat)	Nr. i ankesave	Përqindja
1	Komuna Skenderaj	41	10.93 %
2	Komuna Lipjan	19	5.07 %
3	Komuna Gjilan	18	4.80 %
4	Komuna Viti	13	3.47 %
5	Komuna Podujevë	13	3.47 %
6	Komuna Prishtinë	12	3.20 %
7	Komuna Kamenicë	8	2.13 %
8	Komuna Rahovec	7	1.87 %
9	Komuna Obiliq	6	1.60 %
10	Komuna Ferizaj	3	0.80 %
11	Komuna Klinë	3	0.80 %
12	Komuna Vushtrri	3	0.80 %
13	Komuna Mitrovicë	2	0.53 %
14	Komuna Suharekë	2	0.53 %
15	Komuna Gjakovë	2	0.53 %
16	Komuna Graçanicë	2	0.53 %
17	Komuna Drenas	1	0.27 %
18	Komuna Deçan	1	0.27 %
19	Komuna Mamushë	1	0.27 %
	Gjithsejtë	160	42.67 %

Fig.10 Pasqyron të dhënat mbi numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill gjatë vitit 2012, sipas komunave.

Ankesat e arritura, sipas objektit të ankesave kundër Administratës Lokale (Komunave)

Ankesat e arritura kundër Administratës Lokale (Komunave)	Ndërprerje e marrësh. së punës	Mosvazhdim i punësimit	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ulje në pozitë	Rritje koeficientit	Masa disiplinore	Ndërrim i vendit të punës	Transferim	Plotësim norme	Vlerësim i punës	Te tjera	Gjithsejtë
Komuna e Skenderajt	-	-	-	40	-	-	1	-	-	-	-	-	41
Komuna e Lipjanit	1	11	2	1	-	4	-	-	-	-	-	-	19
Komuna e Gjilanit	1	-	4	9	1	-	3	-	-	-	-	-	18

Komuna e Podujevës	-	1	-	1	1	3	-	-	7	-	-	-	13
Komuna e Vitisë	-	1	2	5	2	-	2	-	-	-	1	-	13
Komuna e Prishtinës	2	-	4	2	1	1	1	-	1	-	-	-	12
Komuna e Kamenicës	-	1	3	-	-	-	-	4	-	-	-	-	8
Komuna e Rahovecit	1	1	1	-	2	-	2	-	-	-	-	-	7
Komuna e Obiliqit	-	-	1	-	-	-	-	2	2	-	-	1	6
Komuna e Vushtrrisë	-	-	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Komuna e Klinës	-	-	--	3	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Komuna e Ferizajit	-	-	1	1	-	-	-	-	-	1	-	-	3
Komuna e Shtërpcës	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
Komuna e Suharekës	-	-	1	-	-	-	1	--	-	-	-	-	2
Komuna e Mitrovicës	1	-	1	-	-	-	-	-	-	--	-	-	2
Komuna e Graçanicës	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Komuna e Gjakovës	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	--	-	2
Komuna e Mamushës	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Komuna e Deçanit	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
Komuna e Drenasit	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Gjithsej	9	18	20	68	7	9	10	2	14	1	1	1	160

Fig.11 Pasqyron ankesat sipas objektit, nga nëpunësitë civilë dhe kandidatët për punësim kundër Administratës komunale (komunave)

C. ANKESAT E SHQYRTUARA GJATË VITIT 2012

Këshilli në vitin **2012** ka pranuar **375** ankesa, ndërsa ka shqyrtuar dhe vendosur **382**, ankesa. Prej tyre janë vendosur **348** ankesa të vitit 2012, **34** ankesa të vitit 2011, ndërsa **28** ankesa të vitit 2012 kanë mbetur të shqyrtohen në vitin 2013.

Kolegjet e Këshillit, në pajtim me bazën ligjore kanë shqyrtuar dhe vendosur ankesat në seanca publike-dëgjimore dhe jo publike.

1. Administrata qendrore (ministritë)

Këshilli ka pranuar **118** ankesa kundër vendimeve të organeve të punësimit të Administratës qendrore, prej tyre **105** ankesa te vitit 2012 dhe **17** ankesa të vitit **2011**. Gjithsejtë të vendosura janë **122** ankesa.

Tabela e mëposhtme tregon ankesat kunder Institucioneve të Administratës Qendrore e shqyrtuara të vitit 2012

Institucionet e Administratës Qendrore (Ministritë)	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të pezulluara	Rishqyrtim /Ex-Officio	Jo kompetencë	Përfundim procedimi	Terheqje të ankesës	Nr. ankesave të Shqyrtuara
Ministria e Tregtisë dhe Infrastrukturës	5	5	1	3	-	6	-	-	-	20
Ministria e Drejtësisë	2	4	-	6	-	-	1	-	-	13
Ministria e Shëndetësisë	5	2	1	2	-	1	-	-	-	11
Ministria e Infrastrukturës	2	4	-	1	1	3	-	-	-	11
Ministria e Punëve të Jashtme	6	3	-	-	-	-	-	-	1	10
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	3	6	-	-	-	-	-	-	-	9
Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës	6	-	-	2	1	-	-	-	-	9
Ministria e Punëve të Brendshme	2	5	-	1	-	-	-	-	-	8
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1	2	--	-	-	3	2	-	-	8
Ministria e Administratës Publike ^e	1	-	1	-	1	-	-	-	-	3

Ministria për Komunitete dhe Kthim	-	-	-	2	-	1	-	-	-	3
Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal	-	2	-	-	-	-	1	-	-	3
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	2	-	-	-	-	-	-	-	3
Ministria e Diasporës	-	1	-	-	-	-	-	1	-	2
Ministria e Financave	-	-	1	-	-	1	-	-	-	2
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	-	1	-	1	-	-	-	-	-	2
Administrata e Zyrës së Kryeministrit	-	2	-	-	-	-	-	-	-	2
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1
Administrata e Presidencës	1	--	-	-	-	-	-	-	-	1
Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
GJITHSEJTË	36	39	4	19	3	15	4	1	1	122

Fig.12 Tregon ankesat e shqyrtuara të vitit 2012 ndaj Institucioneve të Administratës Qendrore

2. Administrata lokale - (Komunat)

Këshilli ka pranuar **160** ankesa kundër vendimeve të Administratës lokale (komunat), prej tyre **153** ankesa të vitit 2012, dhe **7** ankesa të vitit 2011.

Ankesat e Vendosura sipas Autoriteteve Punëdhënëse (Komunave)

Administrata lokale (Komunat)	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesrisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të pezulluara	Rishqyrtim /Ex-Officio	Jo kompetencë	Përfundim procedimi	Terheqje të ankeses	Nr. ankesave të shqyrtuara
Komuna e Skenderajt	4	37	-	-	-	-	-	-	-	41
Komuna e Lipjanit	2	6	-	-	-	1	12	-	-	21
Komuna e Gjilanit	6	3	4	2	-	-	2	-	-	17
Komuna e Podujevës	5	1	-	1	-	4	1	-	-	12
Komuna e Vitisë	7	3	1	-	-	2	1	-	-	12
Komuna e Prishtinës	3	4	-	1	-	1	-	-	-	9
Komuna e Kamenicës	1	-	-	1	-	1	6	-	-	9
Komuna e Rahovecit	-	5	1	-	-	1	-	-	-	7
Komuna e Obiliqit	3	2	-	-	1	1	-	-	-	7
Komuna e Gjakovës	-	3	-	-	-	-	-	-	-	3
Komuna e Shtërpçës	-	1	-	-	-	2	-	-	-	3
Komuna e Vushtrrisë	1	1	1	-	-	-	-	-	-	3
Komuna e Suharekës	-	2	-	-	-	-	-	-	-	2
Komuna e Mitrovicës	1	-	-	1	-	-	-	-	-	2
Komuna e Klinës	-	1	-	1	-	-	-	-	-	2
Komuna e Ferizajit	1	-	-	-	-	-	1	-	-	2
Komuna e Graçanicës	1	-	-	1	-	-	-	-	-	2
Komuna e Deçanit	-	-	-	-	-	-	--	-	1	1

Komuna e Mamushës	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Komuna e Drenasit	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Komuna e Malishevës	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1
Gjithsejtë	37	69	7	9	1	13	23	0	1	160

Fig.13 Tregon ankesat e shqyrtuara të vitit 2012 ndaj Institucioneve të Administratës lokale (komunave)

3. Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura

Këshilli ka vendosur 100 ankesa, prej tyre 91 ankesa të vitit 2012, ndërsa 9 ankesa të vitit 2011.

<u>Agjencitë, Institucionet dhe Organet e Pavarura</u>	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të pezulluara	Rishqyrtim /Ex- Officio	Jo kompetencë	Përfundim procedimi	Tërheqje të ankesës	Saktësimi vendimi	Nr. ankesave të shqyrtuara
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	10	1	5	1	-	-	2	-	-		19
Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK	5	-	-	-	-	-	1	-	1		7
Agjencioni Pyjor i Kosovës	2	1	-	-	1	1	-	1	-		6
Administrata Tatimore e Kosovës	1	4	-	-	-	1	-	-	-		6
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	-	3	-	-	-	3	-	-	-		6
Policia e Kosovës	-	4	-	-	-	-	1	-	-		5
Agjencioni Kosovar i Privatizimit	-	4	-	1	-	-	-	-	-		5
Agjencia Kadastrale e Kosovës	1	2	-	-	-	-	-	-	-		3
Institucioni i Avokatit të Popullit	1	1	-	-	-	-	-	1	-		3
Agjencia Kundër Korrupsionit	1	2	-	-	-	1	-	-	-		4

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	-	1	-	2	-	--	-	-	-		3
Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale	-	-	-	-	-	1	2	-	-		3
Prokuroria Shtetit-Administrata	-	3	-	-	-	-	-	-	-		3
Agjencia e Statistikave të Kosovës	-	1	-	-	-	1	-	-	-	1	3
Doganat e Kosovës-Administrata	1	-	-	-	-	1	-	-	-		2
Spitali Rajonal në Pejë	-	2	-	-	-	-	-	-	-		2
Njësia e Intelgjencës Financiare	1	1	-	-	-	-	-	-	-		2
Universiteti i Prishtinës	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	2
Qendra Studentëve	-	1	-	-	-	1	-	-	-		2
Agjencioni i Kosovës për Siguri Publike-Vushtrri	-	1	-	-	-	-	-	-	-		1
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	-	1	-	-	-	-	-	-	-		1
Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit	-	-	-	1	-	-	-	-	-		1
Universiteti i Prizrenit	-	1	-	-	-	-	-	-	-		1
QKMF-Prizren	-	1	-	-	-	-	-	-	-		1
QKMF-Klinë	-	-	-	-	-	-	1	-	-		1
Inspektorati Policor i Kosovës	-	-	-	-	-	-	1	-	-		1
Komisioni për Ndihmë Juridike	-	-	-	-	-	1	-	-	-		1
Instituti i Historisë	-	-	-	1	-	-	-	-	-		1
Spitali në Ferizaj	-	-	-	-	-	1	-	-	-		1
Komisioni i Pavarur për Media	1	-	-	-	-	-	-	-	-		1
Akademia e Shkencës dhe Artit të Kosovës	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1

QKMF-Obiliq	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
QKMF-Vushtrri	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
Gjithsejtë	25	35	5	8	1	14	8	2	1	1	100

Fig.14 Tregon ankesat e shqyrtuara të vitit 2012 ndaj Agjencive, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura

Nga të dhënat e mësipërme lidhur me shqyrtimin dhe zgjedhjen e **382** ankesave nga Këshilli, mënyra e vendosjes së këtyre ankesave është si në tabelën në vijim:

Mënyra e vendosjes	Numri	Përqindja
Të refuzuara	143	37.43%
Të aprovuara	98	25.65%
Rishqyrtim/ Ex-officio	42	10.99%
Të hedhura poshtë	36	9.42%
Shpallja jo kompetent	35	9.16%
Të aprovuara pjesërisht	16	4.19%
Të pezulluara	5	1.31%
Përfundim procedimi	3	0.79%
Tërheqje ankese	3	0.79%
Korigjim i vendimit	1	0.26%
Gjithsejtë	382	99.99%

Fig. 15 Tregon mënyrën e vendosjes së ankesave, numrin dhe përqindjen e tyre

Nga **382** vendimime të cilat i ka nxjerr Këshilli, prej tyre të aprovuara **98**, të aprovuara pjesërisht **16** dhe kthim për rishqyrtim **42**, gjithsejt **156** vendime, qw organet e punësimit kanë pasur obligim ligjor për t'i zbatuar.

Përkundër këtij fakti që vendimet e Këshillit janë të formës së prerë në procedurë administrative siç shihet në tabelat e më sipërme prej **156** vendimeve për zbatim organet e punësimit nuk i kanë zbatuar **30** vendime të Këshillit.

Vendimet e ekzekutuara për vitin 2012

Mënyra e vendosjes së vendimeve për ekzekutim	Të ekzekutuara	Vendimet e pa ekzekutuara	Vendimet për ekzekutim
Të aprovuara	81	17	98
Pjesërisht të aprovuara	10	6	16
Kthimi në rishqyrtim/ Ex-officio	35	7	42
GHITHËSEJTË	126	30	156

Nga tabela e mësipërme shihet se janë të ekzekutuara **126** vendime apo **81%**, ndërsa nuk janë ekzekutuar **30** vendime apo **19 %**.

Institucionet që nuk kanë ekzekutuar vendimet

Ministritë	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Komunat	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Agjencitë e pavarura	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara
Ministria e Dejtësisë	1	Komuna e Podujevës	5	Agjencioni Pyjor i Kosovës	2
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	Komuna e Gjilanit	7	Universiteti i Prishtinës	1
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1	Komuna e Obiliqit	2	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	1
Ministria e Punëve të Brendshme	1	Komuna e Skenderajt	2		
Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural	1	Komuna e Rahovecit	1		
Ministria e Administratës Publike	1	Komuna e Lipjanit	1		
		Komuna e Vushtrrisë	1		
		Komuna e Vitisë	1		
Gjithsejtë	6		20		4

Nga tabela e mësipërme shihet se nuk janë ekzekutuar 30 vendime të Këshillit

D. ANKESAT E ZGJIDHURA GJATË VITIT 2012 DHE MËNYRA E ZGJIDHJES SE TYRE

Këshilli gjatë vitit 2012 ka **shqyrtuar dhe vendosur gjithsejtë 382 ankesa**, duke përfshirë edhe ankesat nga viti paraparak.

Mënyrat e zgjidhjes së ankesave

Mënyrat e zgjidhjes së ankesave në Këshill ndahet në: të aprovuara, pjesërisht të aprovuara, të refuzuara, të hedhura poshtë, përfundim procedimi, ri shqyrtim/ex-officio dhe të pezulluara.

1. Të aprovuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësitë civil apo kandidatët për punësim në shërbimin civil, që në bazë të provave dhe fakteve kolegjiet e Këshillit i kanë aprovuar, duke anuluar vendimet e organeve të punësimit, dhe duke i obliguar organet e punësimit për zbatimin e tyre në afatin e përcaktuar ligjor. Numri i ankesave të aprovuara gjatë periudhës raportuese, është **98** ankesa.

2. Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe kur ankesa nuk aprovohet në tërësi. Kjo ndodhë në rastet kur organi punësimit obligohet që të përmbushë ndonjërin nga pretendimet e aprovuara ankimore. Numri i ankesave pjesërisht të aprovuara gjatë periudhës raportuese, është **16** ankesa.

3. Të refuzuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësit civilë të cilat në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura nga ankuesi dhe organi punësimit refuzohen si të pa bazuara. Numri i ankesave të refuzuara gjatë periudhës raportuese, është **143** ankesa.

4. Të hedhura poshtë

Janë ankesat të cilat pranohen dhe procedohen nga ana e Kolegjeve të Këshillit, por që hedhen poshtë kur nuk është respektuar afati ligjor dhe mos plotësimi të ankesës në afatin ligjor nga ankuesi. Numri i ankesave të hedhura poshtë gjatë periudhës raportuese është **36** ankes.

5. Të shpallura jo-kompetent

Janë ankesat të cilat gjatë shqyrtimit të tyre nga Kolegjet e Këshillit konstatohet se për ankesat të cekura nuk është kompetencë e Këshillit për të vendosur lidhur me objektin e këtyre ankesave, që në rastet e tilla veprohet sipas Ligjit të procedurës administrative. Lidhur me ankesat e tilla Këshilli ka konstatuar jo kompetencën e vetë për 35 sosh.

6. Kthimi në ri- shqyrtim (Ex-officio)

Janë vendime të cilat, Këshilli i obligon organet e punësimit brenda afatit ligjor për të ndërmarr veprime procedurale duke nxjerre vendim ose duke i obliguar organet e punësimit për ri-shqyrtim të vendimeve të tyre, dhe pastaj për të vendosur ankesën, sipas objektit të ankimit me vendim përfundimtar administrativ nga Këshilli. Numri i këtyre ankesave të vendosura ri-shqyrtim/ex-officio gjatë periudhës raportuese është 42 ankesa.

7. Përfundim procedimi

Janë vendime kur nëpunësit civil apo kandidatët për shërbim civil tërheqin ankesat, eliminohet arsyeja për ankimin, për shkak të braktisjes së ankesës nga ana e ankuesit, kur pala nuk ka qenë i interesuar dhe jo aktiv mbi tre muaj dhe kur konstatohet se objekti për të cilin është filluar procedimi ka humbur e efektin dhe qëllimin. Numri i ankesave me përfundim procedimi gjatë periudhës raportuese, është 3 ankesa.

8. Të pezulluara

Janë ankesat e nëpunësve civil që për marrjen e vendimit përfundimtar në procedurë administrative duhet të pritët në vendim paraprak të një organi kompetent apo vendim të gjykatës. Numri i ankesave të pezulluara gjatë periudhës raportuese, është 5 ankesa.

9. Tërheqje e ankesës

Janë ankesa me të cilën ankuesi heq dorë vullnetarisht me shkrim nga shqyrtimi i ankesës. Numri i tyre është 3 ankesa.

10. Saktësimi i vendimit

Nër rastet kur nga ankuesi në procedurë përmbartimore kërkohet që titulli ekzekutiv të saktësohet është 1 kërkesë/ankesë.

E. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT

Vendimet e Këshillit janë të obligueshme që të zbatohen nga organet e punësimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin. Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe duhet të ekzekutohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Mosekzekutimi i tyre nga personat përgjegjës, konsiderohet cenim i të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësit në shërbimin civil dhe paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës të parapara në ligjin për shërbimin civil të Kosovës.

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.03/L-192 për Këshillin përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit janë nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues, zyrtarët kryesor të administratës komunale dhe përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit.

Në pajtim me nenin 15 parag. 2, 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin, pas kalimit të afatit për ekzekutim të vendimit në afatin e përcaktuar ligjor, Këshilli në mënyrë të rregullt ka njoftuar Kryeministrin (33 njoftime), eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim (33 njoftime) dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës (33 njoftime), lidhur me mos ekzekutimin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli vazhdimisht ka bërë përpjekje për zbatim të vendimeve të Këshillit, duke konstatuar se asnjë nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues, i obliguar për zbatimin e tyre nuk i është nënshtruar përgjegjësisë disiplinore, siç parashihet me nenin 15 parag. 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Këshillin dhe më Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Mos zbatimi i vendimeve të Këshillit, nuk është vetëm përgjegjësi disiplinore, por edhe përgjegjësi penale në pajtim me nenet **221 dhe 222** të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 13 i Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin, saktëson se Vendimet e KPMSHCK-së janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme në procedurë administrative dhe se ankesa e ushtruar kundër vendimit të Këshillit nuk e ndalon ekzekutimin. Në një vendim të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut konkludohet se vendimet e KPMSHCK –së janë vendime administrative përfundimtare dhe se procedurat gjyqësore nuk e ndalojnë ekzekutimin e vendimit të Këshillit. Në bazë të nenit 101.2 i Kushtetutës, përcakton: "Këshilli është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës".

Ne këtë drejtim edhe Gjykata Kushtetuese vëren që vendimet e Këshillit janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme në procedurë administrative dhe se ankesa e ushtruar kundër vendimit të Këshillit sipas nenit 13 të Ligjit për Këshillin nuk e ndalon ekzekutimin e vendimeve të tilla.

Këshilli vazhdimisht ka bërë përpjekje që vendimet, duhet të zbatohen në pajtim me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventën Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut, nenin 15 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 116 të Ligjit për Procedurën Administrative, nenin 24, 293 dhe 294 të Ligjit për procedurën përmbartimore.

Mos zbatimi i vendimeve të Këshillit ngre çështjen sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] dhe neni 32 (e Drejta për Mjete Juridike) të Kushtetutës, sipas të cilit çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Sipas Gjykatës Kushtetuese mos zbatimi i vendimeve nga organet kompetente duke mos zbatuar vendimin e Këshillit, shkelin nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane.

Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike dhe presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet administrative që janë bërë përfundimtare dhe të përmbartueshme.

Po të mos ishte kështu, mos zbatimi i vendimeve përfundimtare do të rezultojë në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin e publikut në administratën shtetërore dhe publike dhe, si rrjedhojë, edhe në sundimin e të drejtës.

Mos ekzekutimi i vendimeve në afatin ligjor, nga organet e punësimit ka për pasojë dëmtimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, që vjen deri tek dyfishimi i kompensimit për punëtorët që janë punësuar ende pa i përfunduar procedurat ankimore me vendim përfundimtar deri në ekzekutim.

F. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES

Vlerësimi i respektimit të ligjit

Këshilli ka ushtruar funksionin e mbikëqyrjes në bazë të nenit 10 paragrafi 3 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L 192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke mbikëqyrur zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të akteve nënligjore, të cilat rregullojnë çështjet e menaxhimit, organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimi në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civil, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

Këshilli për vitin 2012, ka pasur në planin e punës realizimin e **112 vizita** në Institucione qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, për funksionin e mbikëqyrjes së respektimit të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, por ka realizuar **97 vizita**, ndërsa **15** te pa realizuara .

Këshilli gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në vitin 2012 ka rekomanduar Institucionet t'i zbatojnë rekomandimet në kuadër të ndihmës për përmirësimin e punës së njësive të personelit, duke shqyrtuar dosjet e personelit si dhe u kërkua nga institucionet që të evidentoheshin problemet me të cilat ata ndeshen në praktikën e punës së përditshme të tyre.

1. FUSHAT E MBIKËQYRJES NË SHËRBIMIN CIVIL

Njësitë e personelit

Shumica e institucioneve si qendrore ashtu edhe ato lokale janë në përmirësim plotësisht obligimin ligjor që menaxheri apo udhëheqësi i personelit të ketë rolin, përgjegjësitë dhe autorizimet që i takojnë me ligj dhe në disa institucione janë në zbatim të përmbushjes së kriterit, mirëpo është nevojshme që t'iu njihet pavarësia profesionale dhe mos të jenë në presion nga Zyrtarët Kryesor Administrativ. Në kuptim të respektimit të këtij kriteri Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat i obligon të gjitha institucionet në nivelin qendror dhe lokal që të bëjnë riorganizimin e njësive të personelit (burimeve njerëzore), në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Pranimi në shërbimin civil

Gjatë vizitave që anëtarët e Këshillit kanë zhvilluar nëpër institucione të ndryshme kanë konstatuar se ka përmirësime të dukshëm mbi bazën e respektimit të procedurave të rekrutimit gjegjësisht nenin 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 10 paragrafi 1.2 dhe nenin 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues dhe kandidatët për punësim në këto pozita kanë të drejtë ankese në Këshill, ndërsa procedurat e përzgjedhjes përfundimtare para emërimit nga Qeveria i kryen MAP-i. Në këtë drejtim janë krijuar disa paqartësi rreth kompetencës të së drejtës ankimore në Këshill, me rastin e kontestimeve të konkursit për nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues, ku kjo e drejtë i`u është mohuar nga Komisioni i Vlerësimit të Kritereve si dhe opinionin ligjor i dhënë nga ana e zyrës ligjore të Kryeministrit, se Këshilli nuk ka kompetencë të shqyrtojë ankesat e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues, deri sa është e qartë se me nenin 23 dhe 88 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil, që i nënshtrohen të gjitha rregullave dhe parimeve të shërbimit civil. Nxjerrja e Rregullores për emërimin e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues, ka lënë zbrazëti ligjore, lidhur me të drejtën e ankimit. Me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësve të lartë disiplinor nuk respektohen afatet ligjore për nxjerrjen e vendimeve meritore nga Komisioni disiplinor i emëruar nga Qeveria. Por, Këshilli me rastin e pranimit të ankesave të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe kandidatëve për punësim për këto pozita, ka shqyrtuar dhe vendosur, duke u bazuar në dy shkallëshmëri, sipas nenit 50 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 38 dhe 101 të Ligjit për Procedurën Administrative dhe Rregullores për procedurat e rekrutimit për nëpunës civil.

Këshilli ka konstatuar se disa institucione kanë vende të lira të punës dhe nuk procedojnë rekrutimin në pajtim me ligjin, por i mbajnë me ushtrues detyre, duke tejkaluar afatet ligjore.

Rekrutimi i disa pozitave në shërbimin civil nuk bëhet në pajtim me përshkrimin e detyrave të punës dhe kualifikimit profesional të kërkuar siç është përcaktuar me Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës lidhur me përgatitjen profesionale dhe përvojën e nevojshme.

Pranimi në shërbimin civil të personave më aftësi të kufizuar

Edhe për kundër faktit se Ligji për personat me aftësi të kufizuar, që obligon të gjitha institucionet që në çdo 50 të punësuar duhet të punësohet edhe një nëpunës civil me aftësi të kufizuar, ende ky obligim ligjor nuk është duke u përmbushur. Institucionet

e të gjitha niveleve nuk kanë politika por as planifikim të resurseve njerëzore ku do të përfshihej edhe rekrutimi i personave me aftësi të kufizuar si obligim jo vetëm ligjor por edhe nga parimet e Kombeve të Bashkuara dhe Konventave ndërkombëtare për këtë kategori të qytetarëve.

Përfaqësimi i komuniteteve dhe ai gjinor në shërbimin civil

Neni 61 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 11 paragraf 2 dhe 3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe neni 3 paragraf 2 nënparagraf 2.1 dhe 2.3 të Rregullores nr.04/2010 për Procedurat e Përfaqësimit të Drejtë dhe Proporcional të Komuniteteve Joshumicë në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës kanë përcaktuar qartë se komunitet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil në organet e administratës publike qendrore dhe lokale dhe në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit.

Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në institucione qendrore është i ndryshëm dhe në kontrast, sepse në ndonjë institucion ka të përfaqësuar mbi përqindjen e përcaktuar proporcionale, ndërsa në institucione tjera nën nivelin e përqindjes së përcaktuar proporcionale.

Në Administratën Lokale përfaqësimi proporcional është i kënaqshëm, por ka komuna që e kanë tejkaluar përfaqësimin proporcional.

Sipas të dhënave të siguruar nga monitorimi konstatohet se shqiptarët janë të përfaqësuar me 90%, sebët 6.90%, boshnjakët 1.35%, turqit 1.15%, goranët 0.095%, shkali 1.77%, egjiptas 0.08%, romët 0.177% etj.

Përfaqësimi i femrës në shërbimin civil

Baza ligjore që rregullon përfaqësimin e barabartë të meshkujve dhe femrave në shërbimin civil është gjithëpërfshirëse përmes inkurajimit për punësim në shpalljet publike, parimeve të trajtimit të barabartë, mos diskriminimit dhe mundësive të barabarta, por jo edhe e përfaqësuar drejtë në poste drejtuese dhe vendim-marrjes. Në institucione mungojnë politikat dhe planet e zhvillimit të karrierës së femrës përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe ngritjes në pozitë.

Sipas të dhënave të siguruar nga monitorimi konstatohet se struktura gjinore në shërbimin civil është 64.35% meshkuj dhe 35.65% femra, që do të thotë ende nuk është arritur përqindja e dëshiruar prej 40%.

Zëvendësimi i kontratave të nëpunësve civilë

Gjatë monitorimit Këshilli ka konstatuar se në krahasim me vitin e kaluar ka përmirësime të dukshme në organet e punësimit të cilat janë duke përmbushur rekomandimin e Këshillit lidhur me përfundimin e zëvendësimit të kontratave të punës më shkresë emërim pa afat për nëpunësit civil të karrierës në pajtim me nenin 96 dhe 97 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke anashkaluar afatin ligjor siç është përcaktuar me ligj. Shkak për mos zëvendësimin e kontratave të punës më shkresë emërim brenda afatit ligjor, zyrtarët e institucioneve komunale dhe qendrore e kanë arsyetuar me vonesën në fillim të nxjerrjes së rregullores për klasifikimin e vendeve të punës e pastaj mos zbatimin e saj praktik për të klasifikuar vendet e punës i cili proces ka ngecur.

Komisionet disiplinore dhe Procedurat disiplinore

Këshilli ka vërejtur se disa institucione nuk kanë themeluar komisionin disiplinor në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren për proceduar disiplinore në shërbimin civil. Lidhur me përgjegjësinë disiplinore shpesh merren vendime arbitrare pa u proceduar përmes menaxherit të personelit dhe komisionit disiplinor. Në disa institucione nëpunësit civil nuk janë të njoftuar me Kodin e mirësjelljes për nëpunësit civil, që nënkupton edhe mungesën e informacioneve mbi konfliktin e interesit. Andaj me qëllim të detyrimit të organit punëdhënës që t'i respektojë dispozitat ligjore të kësaj fushe, Këshilli ka nxjerr rekomandime sipas të cilave rekomandon institucionet që të formojnë komisionet disiplinore në pajtim me nenin 70 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Shqiptimi i masave disiplinore në disa raste nuk janë proporcion me shkeljet e bëra nga nëpunësit civil, këtë situatë e ka sjell mos caktimi i zyrtarëve adekuat në komisione disiplinore dhe mungesa e trajnimeve në fushën e shërbimit civil.

Komisionet disiplinore shpesh nga zyrtarët kryesor administrativ janë emëruar në baza nepotike, politike dhe të dëgjueshmërisë duke iu nënshtruar ndikimit për të marr vendime jo meritore në kundërshtim me parimet dhe rregullat.

Nëpunësit drejtues apo të lartë shpesh me vendime arbitrare shqiptojnë masa disiplinore pa u përfillur procedurat ligjore dhe procedurale dhe pa bërë kualifikimin paraprak të shkeljes.

Institucionet me rastin e procedimit disiplinor nuk marrin parasysh përmirësimin e sjelljes së nëpunësit civil por ndëshkimin.

Komisionet e Zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave dhe Procedurat

Kolegjet e Këshillit gjatë monitorimit për vitin 2012 , kanë vërejtur se disa organe të punësimit nuk i zbatojnë rekomandimet e Këshillit edhe pse që nga viti 2010 janë të obliguar që të formojnë Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në pajtim me nenin 81 dhe 82 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ankesat brenda organeve të punësimit shpesh nuk shqyrtohen fare brenda afatit ligjor edhe pse kanë detyrim për t'iu përgjigjur ankesave të nëpunësve civil, që në disa raste ankesat fare nuk shqyrtohen brenda organit të punësimit, dhe për shkak të heshtjes administrative nëpunësit civil apo kandidatët për punësim i drejtohen Këshillit. Në shumë raste Këshilli me vendime të ndërmjetme obligon organet e punësimit që të shqyrtojnë ankesën e nëpunësit apo kandidatit për punësim, kështu që kjo shkakton vonesën për shqyrtim të ankesës nga ana e Kolegjeve të Këshillit për të nxjerr vendim përfundimtare.

Komisionet disiplinore shpesh nga zyrtarët kryesor administrativ janë emëruar në baza nepotike, politike dhe të dëgjueshmërisë duke iu nënshtruar ndikimit për të marr vendime jo meritore në kundërshtim me parimet dhe rregullat.

Edhe në rastet kur Këshilli anulon disa vendime të të njëjtit komision të të njëjtit institucion përgjegjësit e institucionit nuk ndërmarrin veprimin e shkarkimit të anëtarëve të komisionit.

Procedura e periudhës provuese

Këshilli gjatë monitorimit ka vërejtur se disa institucione në krahasim me vitin 2011 janë në përmirësim të zbatimit të zbatimit të periudhës provuese me kohëzgjatje 12 muajsh për pozitën e nëpunësve civil të karrierës, dhe vlerësimi i përfundimit të periudhës provuese e cila bëhet në pajtim me procedurat dhe ligjin. Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat janë obliguar organet e punësimit, që të veprojnë sipas nenit 21 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Disa institucione periudhën provuese nuk e kanë dhënë në pajtim me Ligjin për shërbimin civil dhe Rregulloren për procedurën e rekrutimit, që për nëpunësit civil të karrierës është 12 muaj ndërsa për nëpunësit civil jo-karrierës është 3 muaj, që arsye është mos njohja e përgjegjësve të bazën ligjore. Këshilli vëren se për periudhën provuese mangësitë janë mos caktimi i planit dhe objektivave gjatë periudhës provuese, ofrimit të trajnimeve adekuate dhe mos vlerësimit të periudhës provuese në afatin ligjor në pajtim me ligjin ,procedurat dhe parimet.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Këshilli ka vërejtur se ndërprerja e marrëdhënies së punës në disa institucione është bërë në kundërshtim me procedurat dhe bazën ligjore. Disa institucione iu kanë ndërprerë marrëdhënien e punës nëpunësve civil në mënyrë arbitrare me bazë ligjore të gabuar dhe pa arsyetuar vendimet e veta. Ndërprerja e marrëdhënies së punës kryesisht bëhet me masë disiplinore, për shkelje të Kodit të Mirësjelljes, mungesave nga puna, performancës së pakënaqshme, keq menaxhimit, reagimit apo kundërshtimit të eprorit, inicimi i hetimeve për vepër penale, keqpërdorimit të detyrës zyrtare, etj.

Përfundimi i marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit nuk është zbatuar e drejta e kompensimit me rastin e pensionimit në pajtim me Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil. Numri më i madh i ankesave gjatë vitit 2012 ka qenë për kompensimin e shtesave të nëpunësve civil me rastin e pensionimit për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare, që edhe përkundër Ligjit mbi Pagat e Nëpunësve Civil dhe Kontratës Kolektive organet e punësimit iu kanë refuzuar kërkesë/ankesat.

Përshkrimet e punës

Shumica e institucioneve ende nuk kanë standardizuar përshkrimet e punës, gjegjësisht rregulloret mbi sistematizimin e vendeve të punës, duke kaluar procedimin e rishikimit të tyre dhe aprovimit përfundimisht nga menaxherët e personelit dhe zyrtari kryesor administrativ. Ndaj me qëllim që të përmbushet edhe ky kusht në pajtim me dispozitat e Rregullores mbi përshkrimin e vendeve të punës, Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka rekomanduar organet e punësimit që t'i bëjnë përshkrimin e vendeve të punës në afatin ligjor, duke rekomanduar veçanërisht që për titull të caktuar të punës të përcaktuar përgatitjen profesionale me një profesion dhe jo dy e më shumë.

Klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil

Shumica e institucioneve ende nuk kanë përfunduar klasifikimin e vendeve të punës, sistematizimin e vendeve të punës dhe Rregulloren e brendshme në pajtim me Rregulloren nr. 05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës, mbi këtë bazë Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka rekomanduar organet e punësimit që t'i bëjnë përfundimin e klasifikimit të vendeve të punës, sistematizimin dhe Rregulloren e brendshme, në afatin ligjor, mirëpo Këshilli ka konstatuar se mos zbatimi i rregullores ka ngecur me fajin e Ministrisë së

Administratës Publike dhe partnerëve tjerë institucional për të bërë klasifikimin e vendeve të punës në mënyrë që të sigurohet një sistem i standardizuar i pagave.

Vlerësimi i kryerjes së punëve

Lidhur me këtë Këshilli, ka vërejtur se organet punësimit relativisht kanë zbatuar rekomandimet që i ka dhënë Këshilli për vlerësim të kryerjes së punëve për vitin kalendarik. Vlerësimi në disa raste është bërë në mënyrë fiktive, ndërsa gjatë vizitave në shumë raste kemi inkurajuar se vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë objektive, duke respektuar parimet e shërbimit civil dhe atë të meritë meritës, në pajtim me nenin 33 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Mbi këtë bazë Këshilli ka rekomanduar autoritetet punëdhënëse që të respektojnë zbatimin e Rregullores nr. 19/2012 për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe formularin për vlerësimin e rezultateve në punës. Pengesa për zbatimin e Rregullores për rezultatet në punë është vet Ministria e Administratës Publike e cila iu është drejtuar institucioneve që mos të zbatohet, që paraqet vonesa në krijimin e sistemit të vlerësimit në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të shërbimit civil.

Transferimi i nëpunësve civilë

Për procedurën e transferimit të nëpunësve civilë, Këshilli ka vërejtur se organet punësimit kryesisht transferimet i kanë zbatuar në raste të veçanta, në bazë të vendimit të komisionet disiplinor me ç' rast edhe ju është bere transferim nëpunësit civilë. Lidhur me këtë Këshilli ka rekomanduar që të zbatohet neni 28 i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorja nr. 06/2010 për transferimin e nëpunësve civil. Transferimet në disa institucione si ato qendrore dhe lokale bëhen arbitrarisht bëhen pa u përfillur procedurat, shpesh si masë disiplinore pa u arritur pëlqimi dhe duke dëmtuar zhvillimin e karrierës së nëpunësve civilë.

Avancimi në karrierë i nëpunësve civilë

Këshilli në disa institucione ka vërejtur se avancimi i nëpunësve civilë është zbatuar në bazë të nenit 27 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për një pozitë më të lartë funksionale ose gradë kjo procedurë ka krijuar paqartësi brenda shërbimit civil të karrierës deri sa është nxjerrë Rregullorja nr. 21/2012 për avancimin në shërbimin civil.

Këshilli mbi këtë bazë ka rekomanduar që të zbatohet neni 27 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorja nr. 21/2012 për avancimin e karrierës në shërbimin civilë që përcakton procedurën e avancimit të nëpunësve civil në karrierë në organet e punësimit. Rregullorja bie ndesh me ligjin, sepse me rastin e avancimit ka obliguar organet e punësimit për të bërë bazë

konkurruese që është në kundërshtim me parimin e meritës, duke bërë procedime formale.

Pushimet në shërbimin civil

Procedurat pushimeve menaxhohen sipas procedurave të Rregullores nr. 06/2011 për pushimet e nëpunësve civil , po ashtu aplikohet edhe pushimi në bazë të përvojës së punës së deklaruar dhe të dëshmuar, por është vërejtur se disa institucione kanë problem me lejimin e pushimeve mjekësore të stërzgjatura si rezultat i sëmundjeve të rënda. Vështirësitë janë në lejimin e pushimeve pa pagesë, sepse nuk është përcaktuar afati i kohëzgjatjes, gjë që paraqet problem të dyanshëm qoftë për t'iu mos lejuar një pushim i tillë,por qoftë edhe për t'iu lejuar në kundërshtim me parimet e shërbimit civil.

Orari i punës dhe vijueshmëria

Pothuajse në të gjitha institucionet menaxhohet vijueshmëria në punë dhe respektimi i orarit të punës, ne formën elektronike. Me përjashtim disa organe te punësimit të cilat akoma nuk kane një mekanizëm të ndërtuar mbi të dhënat e ardhje-vajtjes nga puna për këtë arsye Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka obliguar organet e punësimit, që t'i plotësojë këtë kusht.

Dosjet e personelit

Administrimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit janë në përmirësim të standardeve të kërkuara nga baza ligjore në fuqi. Në disa institucione është vërejtur se dosjet personelit nuk mbahen në vende të sigurta, nuk janë të kompletuara me të dhënat personale dhe nuk freskohen në baza të rregullave për t'iu bashkangjitur ngritjen dhe zhvillimin profesional individual të nëpunësve civil. Këshilli ka udhëzuar-rekomanduar menaxherët e personelit që të zbatohet Rregullorja nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civilë dhe që me rastin e rekrutimit të sigurojnë të dhënat për gjendjen civile dhe dosjen penale, të kandidatëve të rekrutuar .

Trajnimet dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale

Këshilli gjatë monitorimit të institucioneve ka vërejtur se planifikimi, programi dhe strategjia e trajnimeve të nëpunësve civil nuk është në nivelin e nevojave për trajnim dhe zhvillimit profesional të personelit. Vërehet se organet e punësimit dhe IKAP nuk kanë bërë analiza të mirëfillta për nevojat e trajnimit për stafin civil, gjë që shpesh herë trajnimet bëhen formale dhe në as një rast nuk është bërë vlerësimi i cilësisë së trajnimeve, duke vlerësuar se sa kanë ndikuar trajnimet në ngritjen e kapaciteteve për vet nëpunësin civil dhe institucionin në tërësi.

Nga të dhënat gjatë vizitave dhe të siguruara nga institucionet konstatohet se në vitin 2012 IKAP-i ka trajnuar **2227** nëpunës civilë nëpërmjet **101** kurseve të trajnimit , të zhvilluar me **274** ditë trajnim.

Struktura gjinore e pjesëmarrësve në trajnim përbehet nga **45.89%** gjinia femrore, **53.66%** gjinia mashkullore, **3.10%** nga komunitetet jo shumicë. Pjesëmarrja në trajnime sipas strukturës sipas nivelit të kategorive funksionale të nëpunësve civil është niveli i lartë drejtues **1.70%**, Niveli drejtues **22.94%**, Niveli profesional **65.64%** dhe niveli administrativ-teknik **10.01%**.

Nga këto të dhëna vërehet pjesëmarrja më e madhe në trajnime të nëpunësve civil meshkuj se sa femra, pjesëmarrja tejet e vogël e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë; pjesëmarrja dukshëm më e madhe e nëpunësve civil të nivelit profesional, pjesëmarrja tejet simbolike e nivelit të lartë drejtues në trajnime paraqet shqetësim sepse kanë rol dhe përgjegjësi për të menaxhuar me resurset e institucioneve dhe zbatimin e procedurave, ligjeve dhe parimeve.

Këshilli ka nxjerr rekomandime për të gjitha organet e punësimit që të hartojnë planin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve profesionale për të gjithë nëpunësitë civilë, në pajtim me nenin 35 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke bërë paraprakisht analiza të mirëfillta të nevojave për trajnim të stafit civil.

Në bazë të dhënave të marra nga Institucionet qendrore dhe lokale, Këshilli ka konstatuar se organet e punësimit për vitin 2012 i kanë zbatuar rekomandimet e Këshillit në krahasim me vitin 2011, sepse shihen veprime pozitive të organeve të punësimit për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Vazhdojnë të qëndrojnë disa brenga në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore nga institucionet qendrore dhe lokale, duke mos zbatuar një procedurë rekrutimi me baza meritorë për të shmangur ndërhyrjeve të mundshme politike. Kjo bie barrë e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues të institucioneve që janë përgjegjësitë kryesor për planifikimin, udhëheqjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjit dhe procedurave të shërbimit civil.

G. FUNKSIONI I VËZHGIMIT

Këshilli ka funksionin e vëzhgimit, të procedurave për zgjedhjen e nëpunësve civil të nivelit drejtues në shërbimin civil të Kosovës.

Ky funksion është i paraparë me nenin 10 paragrafi 1.2 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin. Në pajtim me dispozitën e përmendur, organet e punësimit në Shërbimin Civil të Kosovës, janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin, për kohën e mbajtjes së intervistës, për plotësimin e vendeve të punës së nëpunësve civil të nivelit drejtues, që Këshillit për vëzhgim duhet t'i paraqes tërë dokumentacionin e nevojshëm, lidhur me realizimin e konkursit për të cilin Këshilli është ftuar të marrë pjesë në vëzhgim.

Gjatë ushtrimit të këtij funksioni, Këshilli është i ndihmuar me dokumentacion të nevojshëm, duke vërtetuar paraprakisht se a janë plotësuar kushtet për mbajtjen e intervistës, duke kontrolluar dosjen complete të rekrutimit mbi përmbushjan e kriterëve të parapara me Ligjin për Shërbimin Civil me qëllim që përzgjedhja përfundimtare të bëhet në pajtim me parimet udhëheqëse të Shërbimit Civil të Kosovës.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të vëzhgimit Këshilli gjatë periudhës raportuese në organet e punësimit ka realizuar vëzhgimin e zgjedhjes së 46 të nëpunësve civil të nivelit drejtues.

Prej tyre si rekrutime të rregullta, Këshilli i ka nxjerrë 37 vendime për rekrutimin (zgjedhjen) e nëpunësve civil të nivelit drejtues. Këshilli ka gjetur edhe institucione, që me rastin e rekrutimit kanë vepruar në kundërshtim me parimet dhe rregullat e shërbimit civil. Përkundër rezultateve të arritura në vëzhgim dhe përmirësimet e dukshme në zbatimin e procedurave ligjore dhe parimeve të shërbimit civil, disa institucione nuk kanë respektuar dispozitat ligjore lidhur me procedurat e rekrutimit rreth zgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit drejtues, ku ka raste të rekrutimit pa ftuar Këshillin dhe duke mos treguar gadishmeri për bashkëpunim si obligim ligjor.

Nr	Institucioni	Pozita e aprovuar nga KPMShCK
1	Universiteti i Prishtinës	1. Zyrtar i Larte për Marrëdhënie me Jashtë
2	Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë	1. Drejtor i Departamentit për Rezerva Shtetërore 2. Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave 3. Drejtor i Departamentit Ligjor
3	Ministria për Komunitet dhe Kthim	1. Drejtor i Departamentit për Menaxhim dhe Monitorim të Projekteve, 2. Drejtor i Departamentit për Planifikim të Politikave dhe Analizave
4	Ministria për Integritet Evropian	1. Drejtor i Departamentit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm 2. Drejtor i Departamentit të Qeverisjes 3. Drejtor i Zyrës për Koordinimin e Asistencës së Bashkimit Evropian
5	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	1. Kryesues i Departamentit të Rregullimit të Tregut 2. Kryesues i Departamentit për Siguri
6	Ministria e Financave	1. Drejtor i Departamentit Ligjor 2. Drejtor i Departamentit të Administratës 3. Drejtor i Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Publike 4. Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative

7	Ministria e Punëve të Jashtme	1. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm 2. Drejtor i Departamentit për Media
8	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	1. Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm
9	Ministria e Diasporës	2. Drejtor i Departamentit për Politika të Diasporës 3. Drejtor i Departamentit Ligjor
10	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1. Udhëheqës i Departamentit të Energjisë dhe Minierave
11	Agjencia Anti Korrupsion	1. Drejtor i Departamentit për Parandalim
12	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1. Drejtor i Departamentit të Prokurimit 2. Drejtor i Departamentit të Pagesave
13	Ministria e Infrastrukturës	1. Drejtor i Departamentit të Transportit
14	Ministria e Punëve të Brendshme	1. Drejtor i Departamentit të Parandalimit 2. Drejtor i Departamentit të Gatishmërisë 3. Drejtor i Departamentit të Operativës 4. Drejtor i Departamentit të Zjarrfikëseve dhe Shpëtimit
15	Ministria e Administratës Publike	1. Drejtor i Administratës dhe Personelit
16	Institucioni i Avokatit të Popullit	1. Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit
17	Ministria e Drejtësisë	1. Drejtor i Departamentit të Prokurimit
18	Prokuroria e Shtetit	1. Menaxher i Prokurimit 2. Menaxher për Buxhet dhe Financa
19	Gjykata Kushtetuese	1. Drejtor i Departamentit për Regjistrin e Lëndëve, Statistikë dhe Arkivë
20.	Qendra e Studentëve	1. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm
21.	Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale	1. Drejtor i Departamentit të Inspektoratit Faramaceutik 2. Drejtor i Departamentit të LZKKPM.
	Gjithsejtë	37

Pozitat e Drejtoreve të Departamenteve që Këshilli ka marrë pjesë në vëzhgimi po nuk është njoftuar për zgjedhjen e kandidatëve, si në vijim :

Nr	Institucioni	Pozitat
1	Ministria e Infrastrukturës	1. Drejtor i Sekretariatit të Këshillit për Siguri në Komunikacionin Rrugor
2	Zyra e Kryeministrit	Drejtor i Zyrës Administrative
3	Kuvendi i Republikës Kosovës	Drejtor i Departamenti të Prokurimit
	Gjithsejtë	3

Jokompetenca e Këshillit për të vëzhguar, sepse drejtorët e disa institucioneve të MKRS emërohen sipas ligjeve të veçanta.

Nr.	Institucioni	
1	Ministria e Kulturës Rinise dhe Sporteve	Drejtor i Muzeut të Kosovës

V. BUXHETI

Buxheti i aprovuar, për Këshillin, sipas Ligjit 04/L-079, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ka qenë në shumën prej 217.872.00€ i ndarë sipas kategorive ekonomike, në mënyrë tabelore duket kështu:

Nr.	Kategoritë Ekonomike	Buxheti i Aprovuar 04/L-079 - fillestar	Buxheti i rishikuar Final - SIMFK	Ndryshimi
1	Paga dhe mëditje	152.007.00 €	152.007.00 €	00
2	Mallra dhe shërbime	61.365.00 €	61.365.00 €	00
3	Shpenzime kapitale	0 €	0 €	00
4	Shpenzimet komunale	4.500.00 €	4.500.00 €	00
	Totali	217.872.00 €	217.872.00 €	00

Tabela 1 - Alokimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike

Nga tabela e mësipërme shihet qartë se nuk ka dallim në mes të buxhetit fillestar të aprovuar dhe buxhetit final (rishikuar),

A. Mbikëqyrja e shpenzimeve

Gjatë vitit 2012, nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka realizuar **97.29%** të buxhetit të paraparë. Buxheti i realizuar nëpër kategori ekonomike është si vijon:

- Paga dhe Mëditje është shpenzuar në masën **99.99%** .
- Mallra dhe Shërbime është shpenzuar **90.77%** nga buxheti i planifikuar për këtë kategori.
- Shpenzimet e komunale është shpenzuar në masën **95.15%** të buxhetit të planifikuar;

Këto të dhëna në mënyrë tabelare duken si më poshtë:

Nr.	Kodi buxhetor	Buxheti final	Të shpenzuara	Të pa-shpenzuara	Të shprehura në %
1	Paga dhe mëditje	152.007.00 €	151.993.70€	13.30€	99.99
2	Mallra dhe shërbime	61.365.00€	55.700.78€	5.664.22€	90.77
3	Shpenzimet komunale	4.500.00€	4.281.78€	218.22€	95.15
4	Shpenzime kapitale	00	00	00	00
	Totali	217.872.00€	211.976.26	5.895.74€	97.29

VI. BASHKËPUNIMI

Këshilli gjatë vitit raportues ka zhvilluar me tej bazat e kultivimit të frymës së bashkëpunimit të mirë me institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare.

Një bashkëpunim të frytshëm Këshilli ka pasur me Misionin e OSBE në Kosovë dhe me Komisionin për Shërbimin Civil të Republikës së Shqipërisë.

VII. PROBLEMET DHE VËSHTIRËSITË

Problemet dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar Këshilli gjatë periudhës raportuese mund të përmenden:

- Niveli i pakënaqshëm i ekzekutimit të disa vendimeve të Këshillit nga ana e disa organeve të punësimit, përkundër që kanë obligim ligjor t'a bëjnë një gjë të tillë, por edhe papërgjegjësia e disa zyrtarëve kryesor administrativ dhe eprorëve të tyre që nuk zbatojnë institucionin e përgjegjësive të përcaktuara me ligj për mos zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit, tani më të përcaktuara edhe nga Gjykata Kushtetuese.
- Mungesa e hapësirës adekuate (objektit) për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit, edhe përkundër përpjekjeve tek ministria përgjegjëse, si rezultat i kësaj Këshilli nuk ka mundur të bëjë rekrutimin e stafit të nevojshëm të Sekretariatit i cili do të ndihmonte shumë që të zhvillojë një punë me efektive në terren për mbikëqyrjen e institucioneve, lidhur me respektimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil të Kosovës.

- Buxheti i pa mjaftueshëm dhe mungesa e bashkëpunëtorëve profesional që do të lehtësonin punën e Këshillit në mënyrë që t'i kushtohet më shumë rëndësi mbikëqyrjes së respektimit të zbatimit të ligjit dhe gjitha Për faktin që kemi të bëjmë me një organ kushtetues dhe anëtarët e Këshillit janë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, edhe për kundër rritjes së nivelit të pagës nuk është e nivelit i cili ka qenë i përcaktuar me konkursin dhe bazën ligjore me rastin e emërimit.
- Baza ligjore ka obliguar Këshillin që të vëzhgojë përzgjedhjen (rekrutimin) e të gjitha niveleve të kategorisë funksionale të nëpunësve drejtues të katër gradave, por me këtë buxhet dhe mungesën e mjeteve të transportit nuk do të mund të realizohet strategjia e Këshillit por edhe objektive për të ndërtuar një shërbim civil efikas në pajtim me standardet evropiane në shërbim të qytetarëve.
- Baza ligjore për statusin e nëpunësve civilë dhe shërbyesve publik në sektorin publiko-privat është e pa saktësuar në mes të Ligjit për shërbimin civil, akteve nënligjore dhe ligjeve e akteve nënligjore të institucioneve të ndryshme që bien në pyetje të drejtën e ankimit të nëpunësve civil si e drejtë kushtetuese dhe ligjore.
- Mungesa e bashkëpunimit të nevojshëm me institucionet analoge të shteteve të ndryshme që do të mund të t'i shërbente Këshillit në marrjen e përvojave të vendeve që kanë një shërbim më të avancuar të shërbimit civil.

VIII. PËRFUNDIM

Gjatë periudhës raportuese Këshilli, përkundër vështirësive të theksuara ka arritur që të përmbush në përpikëri të tri funksionet të cilat ia përcakton ligji.

Mos ekzekutimi i vendimeve të Këshillit nga ana e disa organeve të punësimit ishte një brengë dhe sfida me e madhe për Këshillin.

Këshilli, për zbatimin e vendimeve nga ana e organeve të punësimit në nivel qendror dhe lokal, pret angazhimin e Qeverisë, të eprorëve të drejtpërdrejtë (ministrat, kryetarët e komunave), të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues të institucioneve (sekretarët e përgjithshëm, kryeshefat ekzekutiv, drejtorët ekzekutiv), Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Gjykatave, që vendimet e Këshillit të zbatohen përfundimisht, në pajtim me ligjin.

Përkushtimi i fuqishëm i Këshillit vazhdon të mbetet sigurimi i një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të besueshëm dhe gjithmonë, sipas rregullave dhe parimeve të shërbimit civil.